



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

RAPORTI / FORMULARI PËR VLERËSIM – F2

Fakulteti	Fakulteti i Edukimit
Lënda/ët për të cilat është shpallur konkursi	<i>Mësimi i gjuhës angleze përmes TI (master Mësimdhënie e Gjuhës Angleze), Teknologji arsimore (master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe), Bazat e teknologjisë informative (Ekonomik), Teknologjia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare (Shkencat Sociale), Teknologji informative (Edukimi Fillor) dhe Sistemet kompjuterike (Edukimi Fillor).</i>
Titulli akademik për të cilën konkurron kandidati	Profesor asistent (Prof. Ass.)
Kandidatët e paraqitur:	Dr. Sc. Refik Ramadani

Sqarime nga Komisioni Vlerësues

Komisioni vlerësues është bazuar në konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Ref. nr. 01/2382 Dt. 05/08/2025, ku në pikën 3. të konkursit nga Fakulteti i Edukimit (emërim për herë të parë në thirrjen përkatëse) kërkohet një (1) mësimdhënës për lëndët: *Mësimi i gjuhës angleze përmes TI (master Mësimdhënie e Gjuhës Angleze), Teknologji arsimore (master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe), Bazat e teknologjisë informative (Ekonomik), Teknologjia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare (Shkencat Sociale), Teknologji informative (Edukimi Fillor) dhe Sistemet kompjuterike (Edukimi Fillor).*

Komisionit i ka arritur vetëm një aplikacion, brenda afatit të përcaktuar kohor në konkurs, nga një kandidat i cili i plotëson kushtet formalo-juridike për t'u trajtuar.

Komisioni, ka shqyrtuar aplikacionin, përkatësisht gjithë dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, vlerësimin për të cilin, duke u bazuar në Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/1328/dt. 26/06/2024, e paraqet në këtë formular.

Komisioni Vlerësues:

1. Prof. Asoc. Dr. Ragmi Mustafa, kryetar
2. Prof. Ass. Dr. Afërdita Ibrahimi, anëtare
3. Prof. Ass. Dr. Shqipe Avdiu-Kryeziu, anëtare

I. TË DHËNAT PËR KANDIDATIN/EN

Emri dhe mbiemri: REFIK RAMADANI

Tabela 1. Të dhënat për kandidatin/en për të cilin shkruhet raporti

Emri dhe mbiemri	Refik Ramadani
Ditëlindja dhe vendlindja	13.11.1990, Gjilan
Grada shkencore dhe viti kur është fituar	Doktor i metodikës së mësimdhënies në informatikë dhe teknologji informative, 2024
Titulli akademik (nëse është rizgjedhje)	
Viti kur është fituar titulli aktual (nëse është rizgjedhje)	
Universiteti/fakulteti/departamenti ku është fituar titulli akademik	
Arsimimi i lartë	
STUDIMET THEMELORE	
Institucioni	Universiteti i Evropës Juglindore
Vendi	Tetovë, Maqedoni e Veriut
Titulli i fituar	Bachelor në Shkenca Kompjuterike
Data / viti i diplomimit	26.12.2013
Fusha e studimit	Shkenca kompjuterike
STUDIMET MASTER / MAGJISTRATURË	
Institucioni	Universiteti i Evropës Juglindore
Vendi	Tetovë, Maqedoni e Veriut
Titulli i fituar	Magjistër i Shkencave Kompjuterike- Aplikimi i teknologjive të informacionit dhe të komunikimit në procesin mësimor
Data / viti i diplomimit	21.4.2016
Fusha e studimit	Shkenca Kompjuterike
STUDIMET E DOKTORATËS	
Institucioni	Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi"
Vendi	Veliko Tërnovo, Bullgari
Titulli i fituar	Doktor në metodologjinë e mësimdhënies në informatikë dhe teknologjitë e informacionit
Fusha e studimit	Metodika e mësimdhënies në informatikë dhe teknologji informative

Tabela 2. Të dhënat për gradën e fituar shkencore dhe titullin akademik

Grada shkencore	Doktor në metodologjinë e mësimdhënies në informatikë dhe teknologjitë e informacionit
Titulli i fituar akademik	
Viti kur është fituar titulli akademik aktual	
Vendimi Ref.nr. ____/____ Dt. ____/____/____	Nr. VT-25 4-0026 Dt.07/04/2025
Universiteti / Fakulteti / Departamenti	Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi", Matematikë dhe Informatikë, Teknologji Informative
Nostrifikimi / MASHT/ NARIC	Ref. nr. 11/3-1676, dt. 16.06.2025

Diskutim/interpretim i të dhënave nga Tabela 2

Të dhënat e paraqitura në tabelën 2 janë të bazuara në dosjen e kandidatit Refik Ramadani, ku dëshmohet se i njëjti ka të përfunduar studimet e doktoratës në *Metodikën e Mësimdhënies në Informatikë dhe Teknologjitë Informative*. Prandaj, sa i përket kësaj pike kandidati Refik Ramadani i plotëson e kushtet, sipas nenit 172, paragrafi 1, pika 1.1 të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.1, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. I njëjti i ka të nostrifikuara diplomën e studimeve themelore, diplomën e studimeve master dhe diplomën e doktoratës, siç kërkohet me konkursin e shpallur për këtë pozitë.

Tabela 3. Monografitë

Nr.	Autori/ët	Titulli i monografisë	Fusha studimore	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti ISBN
1	Refik Ramadani	Nxënësit me nevoja të veçanta dhe teknologjia informative	Teknologji e informacionit dhe mësimdhënie	Ragmi Mustafa Habib Rexhepi	“Embëta”, Prishtinë, 2025, ISBN: 978-9951-424-98-1
2	Refik Ramadani	Zbatimi i teknologjive në procesin mësimor nga nxënësit me nevoja të veçanta	Teknologji e informacionit dhe mësimdhënie		Disertacion i doktoratës

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 3

Kandidati Refik Ramadani ka paraqitur një monografi të botuar, ndërkaq edhe doktorata i njihet si monografi.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 172, paragrafi 1, pika 1.2, të Statutit UKZ-së dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.2 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024, kandidati Refik Ramadani e plotëson këtë kusht formalo-juridik.

Kandidati Refik Ramadani ka të publikuar monografinë me titull “Nxënësit me nevoja të veçanta dhe teknologjia informative”, në të cilën trajton temën që ndërlidhet ngushtë me fushën e studimit, sipas kërkesës së konkursit. Gjithashtu, kandidati ka ofruar edhe punimin e disertacionit të doktoratës me titull “Zbatimi i teknologjive në procesin mësimor nga nxënësit me nevoja të veçanta”. Duhet theksuar se të dy monografitë lidhen ngushtë me lëndët e paraqitura në konkurs.

Tabela 4. Tekstet mësimore

Nr.	Autori/ët	Titulli i tekstit	Recensentët	Shtëpia botuese, vendi, viti, ISBN
1				

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 4

//

Tabela 5. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare shkencore, sipas UA – MASHT No. 01/2018 dhe Nenit 10 pika 4 e Rregullores, Nr.01/1328 dt. 26.06.2024 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Emri i Revistës dhe doi:	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues i databazës
1	Refik Ramadani Arsim Avdiu	The use of computers by students with disabilities in primary school	HUMAN RESEARCH IN REHABILITATION DOI: https://10.21554/hrr.092512	VOL 15, Issue 2 September 2025	https://www.scopus.com/sourceid/21101047721 Punim i indeksuar në SCOPUS
2	Refik Ramadani Ragmi Mustafa	The Impact of Augmented Reality (AR) and Virtual Reality (VR) Technologies on the Teaching Process and Preparing Students for the Future	International Journal of Computational and Experimental Science and Engineering(IJC ESEN) https://doi.org/10.22399/ijcese.n.2092	Vol. 11- No.2(2025) pp. 4061-4068	https://www.scopus.com/sourceid/21101210635 Punim i indeksuar në SCOPUS
3	Ragmi M. Mustafa Kujtim R. Mustafa Refik Ramadani	Digital control of plant development through sensors and microcontrollers in Kosova	The International Journal of Informatics and Communication Technology http://doi.org/10.11591/ijict.v14i3.pp1072-1084	Vol. 14, No. 3 , December 2025 pp. 1072~1084	https://www.scopus.com/sourceid/21101199360 Punim i indeksuar në SCOPUS
4	Ragmi M. Mustafa Kujtim R. Mustafa Refik Ramadani	Creating a smart bedroom for children by connecting PIR and LDR sensors to a microcontroller Arduino UNO ATmega328P	The International Journal of Informatics and Communication Technology http://doi.org/10.11591/ijict.v14i2.pp540-554	Vol. 14, No. 2 , August 2025 , pp. 540~554	https://www.scopus.com/sourceid/21101199360 Punim i indeksuar në SCOPUS
5	Refik Ramadani	Enhancing English Learning for Special Needs Students through Technology	Asian Journal of Research in Computer Science DOI: 10.9734/aj	Volume 17, Issue 6, pp. 126-134, 2024	https://search.worldcat.org/title/1417792692

			rcos/2024/v17i6462		
6	Refik Ramadani Ragmi Mustafa	Benefit of Incorporating Technology in Special Education	Asian Journal of Research in Computer Science DOI: 10.9734/ajrcos/2024/v17i1408	Volume 17 [Issue 1], Pp. 1-10, 2024	https://search.worldcat.org/title/1417792692
7	Refik Ramadani	The Impact of Technology Use on Young People: A Case Study of Social Media and Internet Usage	Asian Journal of Research in Computer Science DOI: 10.9734/ajrcos/2024/v17i7486	Volume 17 [Issue 8], Pp. 13-23, 2024	https://search.worldcat.org/title/1417792692
8	Refik Ramadani Ragmi Mustafa Kujtim Mustafa	The Impact and Benefits of the E-System for Administration Management in Primary and Secondary Schools for Teachers and Parents	Asian Journal of Research in Computer Science DOI: 10.9734/ajrcos/2023/v16i4388	Volume 16, [Issue 4], pp. 271-288, 2023	https://search.worldcat.org/title/1417792692
9	Kujtim Mustafa Ragmi Mustafa Refik Ramadani	Measuring the Voltage, Current and Resistance of the LDR Sensor through the Arduino UNO	Asian Journal of Research in Computer Science DOI: 10.9734/ajrcos/2023/v16i4383	Volume 16, [Issue 4], pp. 211-222, 2023	https://search.worldcat.org/title/1417792692
10	Ragmi Mustafa Kujtim Mustafa Refik Ramadani	Industry-Scale Application of Full-Width Digital Camera Inspection during Effective Printing on Plastic Foil at the Company "Flexograf"	Asian Journal of Research in Computer Science DOI: 10.9734/ajrcos/2023/v16i4389	Volume 16, [Issue 4], pp. 289-296, 2023	https://search.worldcat.org/title/1417792692

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 5

Kandidati Refik Ramadani i ka paraqitur 10 punime shkencore, katër prej të cilëve janë të indeksuar në platformën Scopus, përkatësisht në databazat e përcaktuara nga MASHT, sipas UA-MASHT No. 01/2018.

Me këto publikime, kandidati i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 172, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

Po ashtu, duke qenë kandidat i vetëm në konkurs, Refik Ramadani, për lëndët e caktuara sipas

konkursit dëshmohej se është kuadër deficitar. Prandaj plotëson edhe kushtin e kuadrit deficitar sipas nenit 10, paragrafi 4, pika 1.3 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024

Tabela 6. Punimet e publikuara në revista rajonale (Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, B e H)

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Emri i Revistës dhe doi:	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues i databazës
1	Refik Ramadani Ragmi Mustafa	Bazat teorike dhe didaktike të edukimit të teknologjisë informative në shkollë, përvoja në vendin tim, Kosovë	Centrum - International Scientific Journal https://centrum.mk/wp-content/uploads/2023/12/PJESA-21.pdf	20 , 306-316, 2023	https://centrum.mk/?page_id=1138

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 6

Kandidati Refik Ramadani ka një punim të publikuar në *Procedings Book* të konferencës ndërkombëtare rajonale jashtë territorit të Republikës së Kosovës, sipas nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3 Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

Tabela 7. Punimet e publikuara në revista kosovare

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Emri i Revistës dhe doi:	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues i databazës
1					

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 7

//

Tabela 8. Prezantimet në konferenca

Nr.	Autori/ët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi etj.	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues i databzës
1	Refik Ramadani	<i>Teaching Through Augmented and Virtual Reality</i>	UKZ 2024 - Trends and challenges in the development of <u>contemporary</u> society	Session Edu Day Conference	https://conference2024.unigjilan.net/eduday
2	Refik Ramadani	<i>Cryptocurrencies and economic stability</i>	UKZ 2024 - Trends and challenges in the development of <u>contemporary</u> society	Economics Conference	https://conference2024.unigjilan.net/economicconference

3	Elion Ramadani Refik Ramadani	<i>Fin tech: the future of financial services</i>	UKZ 2024 - Trends and challenges in the development of contemporary society	Economics Conference	https://conference2024.unigjilan.net/economicconference
4	Refik Ramadani	The role of technology in the transformation of the educational system: From distance learning to Artificial Intelligence	UKZ 2025 - Technology, Science and Education: Paths to an Intelligent Society	EduDay Conference "Education and Artificial Intelligence"	https://conference2025.unigjilan.net/eduday
5	Refik Ramadani Blerim Haziri Sylë Ukshini	The role of Technology and Cybersecurity in International Relations	UKZ 2025 - Technology, Science and Education: Paths to an Intelligent Society	Social Science Conference "The Effects of Political, Economic and Social Transformations on the Dynamics of International Society"	https://conference2025.unigjilan.net/social-science-conference
6	Refik Ramadani Ragmi Mustafa	Përdorimi i teknologjisë Blockchain për sigurinë dhe transparencën e diplomave	UKZ 2025 - Technology, Science and Education: Paths to an Intelligent Society	DiGiDay Conference "From Smart Systems to Smart Societies: The Role of Emerging Technologies"	https://conference2025.unigjilan.net/digiday

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 8

Kandidati Refik Ramadani, në këtë pjesë ka paraqitur pjesëmarrjen e tij në 6 konferenca të ndryshme shkencore nga fusha e teknologjisë, por edhe nga fushat e tjera.

Tabela 9. Kontribute tjera shkencore dhe profesionale

Nr.	Autoret (renditja si në kontributin shkencor)	Lloji i kontributit shkencor	Vendi, Viti
1			

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 9

//

Tabela 10. Përvoja në mësimdhënie universitare

Periudha e angazhimit (vitet akademike)	Grada shkencore dhe Titulli akademik	Institucioni, Vendi	Programi i studimit	Ligjërues i lëndëve	Vërejtje
2016-2024	Bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime	Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjilan	Shkenca kompjuterike	<i>Inxhinieri Softuerike; Arkitektura e Kompjuterëve dhe S&O; Programimi PLC; . Sensorët dhe Interfejsat; Zhvillimet për Internet; Menaxhim i sistemit të informacioneve; Hyrje në grafikën e kompjuterëve</i>	
2018-2025	Bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime	Universiteti Publik "Kadri Zeka"	Fakulteti Edukimit	<i>Teknologji Informative</i>	
2018-2023	Bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime	Universiteti Publik "Kadri Zeka"	Fakulteti Ekonomik	<i>Aplikimi i softuerëve në biznes; Bazat e teknologjisë informative; Informatikë për ekonomistë; Teknologjia e projekteve</i>	
2023-2025	Bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata	Universiteti Publik "Kadri Zeka"	Fakulteti Ekonomik	<i>Aplikimi i softuerëve në biznes; Bazat e teknologjisë Informative</i>	

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 10

Kandidati Refik Ramadani ka filluar punën akademike në vitin 2016 dhe deri tani ka një përvojë të gjatë në mësimdhënie, kryesisht në UKZ, në periudhën kohore 2016-2025. Fushat e mësimdhënies janë të ndërlidhura me lëndët e shpallura në konkurs. Prandaj, kandidati Refik Ramadani i plotëson kushtet sipas nenit 172, paragrafi 1, pikat 1.4 dhe 1.5, të Statutit të UKZ-së, si dhe nenit 7, paragrafi 1, pikat 1.5 dhe 1.6, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/1328/dt. 26/06/2024.

Tabela 11. Udhëheqje të temave Master dhe të Doktoratës

<i>Periudha e mentorimit</i>	<i>Institucioni, Vendi</i>	<i>Titulli i temës</i>	<i>Master / Doktoratë</i>	<i>Vërejtje</i>

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 11

//

Tabela 12. Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

<i>Nr.</i>	<i>Programi/ projekti shkencor</i>	<i>Periudha kohore</i>	<i>Institucioni, Vendi</i>	<i>Pozita ne program, projekt/ Kontribut</i>
1	Student-run Multidisciplinary Allied Health Practice Center (SMAHPC)	2020-2023	Erasmus programme UKZ	Anëtar
2	Towards a quality-oriented system of initial teacher education to increase teacher professionalism in Kosovo (QATEK)	2021-2024	Erasmus programme UKZ	Anëtar
3	Circular Economy and Sustainable Practices to Promote a Well-being Economy in Higher Education (SUSWELL)	2023	Erasmus programme UKZ	Anëtar
4	Quality development of international cooperation and project management (QUADIC)	2020-2023	Erasmus programme UKZ	Anëtar
5	Western Balkan higher educational courses in data Journalism Workshop (WEBJOU)	2025	Erasmus programme UKZ	Anëtar
6	Student-run Multidisciplinary Allied Health Practice Center (SMAHPC)	2020-2023	Erasmus programme UKZ	Anëtar
7	Towards a quality-oriented system of initial teacher education to increase teacher professionalism in Kosovo (QATEK)	2021-2024	Erasmus programme UKZ	Anëtar
8	Circular Economy and Sustainable Practices to Promote a Well-being Economy in Higher Education (SUSWELL)	2023	Erasmus programme UKZ	Anëtar
9	Quality development of international cooperation and project management (QUADIC)	2020-2023	Erasmus programme UKZ	Anëtar
10	Western Balkan higher educational courses in data Journalism Workshop (WEBJOU)	2025	Erasmus programme UKZ	Anëtar
11	Student-run Multidisciplinary Allied	2020-2023	Erasmus	Anëtar

	Health Practice Center (SMAHPC)		programme UKZ	
13	Towards a quality-oriented system of initial teacher education to increase teacher professionalism in Kosovo (QATEK)	2021-2024	Erasmus programme UKZ	Anëtar
14	Circular Economy and Sustainable Practices to Promote a Well-being Economy in Higher Education (SUSWELL)	2023	Erasmus programme UKZ	Anëtar

Diskutim/interpretim i të dhënave të paraqitura në tabelën 12

Kandidati Refik Ramadani ka paraqitur pjesëmarrjen e tij 14 projekte Erasmus +, 2020-2025.

II. PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

THIRRJA AKADEMIKE E CILA PROPOZOHET: **Profesor asistent (Prof. Ass.)**

Komisioni vlerësues, i formuar me Vendimin e Këshillit të Fakultetit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, Ref.nr. 492 Dt. 12.08.2025, duke u bazuar në nenin 172 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Publik "Kadri Zeka", Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, rrimërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024 dhe konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan, Ref. nr. 01/2382 Dt. 05/08/2025, pas shqyrtimit të dosjes së kandidatit të vetëm që është paraqitur në konkurs, për pozitën e një mësimsdhënësi për lëndët: *Mësimi i gjuhës angleze përmes TI (Master Mësimdhënie e Gjuhës Angleze), Teknologji arsimore (Master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe), Bazat e teknologjisë informative (Ekonomik), Teknologjia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare (Shkencat Sociale), Teknologji informative (Edukimi Fillor) dhe Sistemet kompjuterike (Edukimi Fillor).*

PROPOZON

Dr. Sc. Refik Ramadanin për thirrjen akademike **Profesor Asistent (Prof. Ass.)** në Fakultetin e Edukimit pranë Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan.

ARSYETIM

Duke u bazuar në nenin 172 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan; nenin 7, Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, rrimërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024 dhe konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan, Ref. nr. 01/2382 Dt. 05/08/2025, si dhe në dokumentacionin e kandidatit, Komisioni vlerësues, njëzëri propozon që kandidati Dr. Sc. Refik Ramadani të zgjedhet në thirrjen **Profesor asistent (Prof. Ass.)** për lëndët: *Mësimi i gjuhës angleze përmes TI (master Mësimdhënie e Gjuhës Angleze), Teknologji arsimore (master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe), Bazat e teknologjisë informative (Ekonomik), Teknologjia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare (Shkencat Sociale), Teknologji informative (Edukimi Fillor) dhe Sistemet kompjuterike (Edukimi Fillor)*

Këtë propozim, komisioni e bazon në këto fakte të detajuara:

- Kandidati Refik Ramadani është Doktor i metodikës së mësimsdhënies në informatikë dhe teknologji informative, me çka i plotëson kushtet formalo-juridike në përputhje me nenin 172, pika 1, nënpika

1.1 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe nenit 7, pika 1, nënplikat 1.1, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.

- Kandidati Refik Ramadani ka të botuar një monografi nga fusha e teknologjisë informative dhe mësimdhënies, përderisa edhe doktorata i njihet si monografi, me çka i plotëson kushtet sipas nenit 172, pika 1, nënplika 1.2 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe nenit 7, pika 1, nënplikat 1.2, të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.
- Kandidati Refik Ramadani ka botuar 10 punime shkencore në revista të indeksuara në platformën Scopus dhe në platforma te tjera të kërkuara nga MASHTI (Udhëzimi administrativ MASHT 01/2018). Në këtë mënyrë kandidati i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 172, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe të nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. Po kështu kandidati Refik Ramadani me punimet e tij të indeksuara në platformat e kërkuara i përmbush kriteret sipas kërkesave të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, Vendimi nr. 3236/211), datë: 21.09.2021, për përditësimin e Manualit të akreditimit dhe Udhëzimit Administrativ nga MASHT 01/2018.
- Kandidati Refik Ramadani ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore, me çka i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 7, paragrafi 1, pika 1.4 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024.
- Kandidati Refik Ramadani ka një përvojë të gjatë në arsimin e lartë, madje pikërisht në UKZ, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, në Fakultetin Ekonomik, si dhe në Fakultetin e Edukimit, ku ka qenë i angazhuar, qoftë si asistent, qoftë si ligjërues në lëndët nga fusha e teknologjisë informative, të cilat janë në përputhje me kërkesat e konkursit, me çka i plotëson kushtet formalo-juridike, sipas nenit 172, paragrafi 1, pika 1.4 dhe pika 1.5, të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe të nenit 7, paragrafi 1, pika 1.5 dhe pika 1.6 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref. nr. 01/1328 dt. 26/06/2024. Po kështu, sipas Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi ka treguar performancë të shkëlqyer në mësimdhënie.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

Prof. Asoc. Dr. Ragmi Mustafa, kryetar

Prof. Ass. Dr. Afërdita Ibrahim, anëtare

Prof. Ass. Dr. Shqipe Avdiu-Kryeziu, anëtare



Gjiilan, më 28 gusht 2025